

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN**  
**NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2022**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke synuar forcimin e mekanizmave institucionale të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, median dhe publikun,

**Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2022 në këto drejtime:**

Realizimin e studimit “Dhuna ndaj grave në politikë”, realizuar në bashkëpunim me Avokatin e Popullit.

Angazhimit për paraqitjen në Kuvend të rekomandimeve për ndryshime ligjore, me qëllim sigurimin e aksesit paralel në skemën e ndihmës ekonomike të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, edhe si viktimë të dhunës, edhe si kategori në nevojë, për shkak të mungesës ose të pamjaftueshmërisë së të ardhurave.

Angazhimit në dhënien e rekomandimeve drejtuar autoriteteve përkatëse për propozime për ndryshime ligjore ose projektligje të reja.

Rritjen e numrit të rekomandimeve për institucionet e administratës shtetërore.

Intensifikimin e bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore.

**Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:**

1. Të angazhohet veçanërisht në zonat rurale për të nxitur respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë minoritetet romë dhe egjiptiane, të moshuarit, njerëzit me probleme të shëndetit mendor, njerëzit me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe vajzat që u përkasin këtyre grupeve, dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për natyrën e problemeve të diskriminimit të konstatuara në këto zona.

2. Të dorëzojë pranë Kuvendit një raport analitik, në lidhje me shkaqet kryesore të rritjes së ankesave për të kuptuar nëse vijnë si rezultat i forcimit të kapaciteteve të KMD-së dhe rritjes së ndërgjegjësimit qytetar apo si rezultat i rritjes së formave të diskriminimit.

3. Të realizojë një studim me fokus shkaqet e diskriminimit dhe të pabarazisë gjinore duke e fokusuar analizën në fusha të veçanta dhe duke analizuar dhe paraqitur rastet sipas sektorëve dhe zonave gjeografike.

4. Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit të zhvillohen sipas një kalendari të përcaktuar aktivitete ndërgjegjësuëse në sistemin arsimor të ulët dhe të mesëm për adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes.

5. Të intensifikojë aktivitetin e tij për adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes tek fëmijët duke rritur numrin e çështjeve të trajtuara *ex officio* (çështje të nisura me iniciativën e KMD-së) për bullizmin në shkollë.

6. Të intensifikojë aktivitetin ndërgjegjësuës përmes përdorimit të medias dhe formave të reja të komunikimit virtual, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe informimin për rolin e KMD-së.

7. Të angazhohet në adresimin në mënyrë proaktive të rasteve të diskriminimit politik në administratën e pushtetit vendor.

KRYETARE  
**Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 8.6.2023.